



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MALIQ

KESHILLI BASHKIAK

PAKETA FISKALE 2017

“Për një qeverisje vendore që synon të rrisë kapacitetet fiskale dhe administrative për realizimin e funksioneve në përgjegjësinë e saj ndaj komunitetit”

VENDIM

NR. 85, DATË 05/12/2016

PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Ne mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 germa f, në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Maliq si vijon:

TAKSAT VENDORE

I. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin
- Taksa mbi tokën bujqësore

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë.

Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

-Taksa mbi ndërtesat

Niveli i taksës mbi ndërtesat: Niveli për kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon:

Kategoritë minimale të ndërtesave	<u>Lekë/m² në vit</u> MALIQ	<u>Lekë/m² në vit</u> NJESITE ADMINISTRATIVE
I. Ndërtesa banimi		
- ndërtuar para 1993	5	2.5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	6	3
II. Ndërtesa të tjera		
- Për tregti dhe shërbime	200	100
- Të tjera	40	20
-Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese.	100	50
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike	400	200

-Afati i pagesës per kategorine II dhe III eshte 20.06.2017

Përfashtime: Përfashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qirramarësit me qira të paliberalizuara.
- c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.
- d) Pasuritë të pronësi të shtetit të kaluara me VKM nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

-Taksa mbi truallin.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Kategorite	Vlera e takses ne lek/m2 ne vit
Familjaret per qellime banimi	0.14
Per biznese	12

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit;

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është Njësia Administrative.

-Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës

Kategorite e tokes	Tarifa sipas ligjit	Tarifa e propozuar
Kategoria e 1	4200	2940
Kategoria e 2	3500	2450
Kategoria e 3	2800	1960
Kategoria e 4	2300	1610
Kategoria e 5	1900	1330
Kategoria e 6	1600	1120
Kategoria e 7 - 10	1400	980

Përfashtime: Përfashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë si dhe sektoret e saj prane Bashkisë Maliq, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë si dhe për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme ia përcjell këtë informacion Drejtorisë së të Ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi token bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është Njësia Administrative.

2. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës se fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Kategorite e Hoteleve	Niveli i taksës në lek/nate fjetje
Fjetina, njësi akomoduese	35

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi fjetjen në hotel është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

3. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. : Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Niveli i taksës se ndikimit në infrastrukture paraqitet si më poshtë:

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Në % të çmimit të shitjes për m ²
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik.	4% - Ndertesa Banimi 6% - Per sherbime (Biznes)
Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Në % të vlerës së investimit
Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër.	2%
Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte	0,1% Por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5%

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Drejtoria e të Ardhurave. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejene e ndërtimit pranë Bashkisë Maliq, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndikimin në infrastrukturë është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është **dy përqind 2%**. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Kategoritë e ndërtesave	Lekë/m2
Ndërtesa banimi	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
Ndërtesa të tjera	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Maliq, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria e Finances pranë Bashkisë Maliq të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZRP

5. TAKSA VJETORE E MJETEVE TE PERDORURA

Baza e taksës: është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTR), para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, **(tetëmbëdhjetë përqind (18%)** të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Maliq në llogarinë e degës së thesarit.

6. TE ARDHURAT PJESORE NGA TAKSA E RENTES MINERARE

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, **pese përqind (5%)** e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Maliq në llogarinë e degës së thesarit.

7. TAKSË E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGI, TV KABLLOR, INTERNET)

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksa pagesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj. Niveli i kësaj takse për Bashkinë Maliq është **50.000 leke ne vit**

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen e taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore është Drejtoria e Kontroll Territorit të Bashkisë Maliq dhe për vjeljen e saj është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

8. TAKSA E TABELËS

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të 23 lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi. Vendorsja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të

Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Niveli i taksës së tabelës paraqitet si më poshtë:

Kategoritë e Tabelave	Niveli I takses
1) Tabelë për qëllime identifikimi: a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	0 lek/vit
b) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	45 000 lek/m2/vit
c) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim	120 lek/vit
2) Tabele për qëllime reklamimi e levizeshme ose jo: a) Tabela të thjeshta	13 500 lek/m2/vit
b) Tabela elektronike	27 000 lek/m2/vit
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1 000 lek/m2/dite

Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.

Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen dhe përlllogaritjen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq (sektori Tax - Force).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje table reklamuese është Policia Bashkiake në Bashkinë Maliq.

9. TATIMI THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizon gjatë vitit fiskal qarkullim më të vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza e taksës/tatimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

- A. Me qarkullim vjetor nga 0 – 5.000.000 0 lekë/vit
- B. Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë 5 % e fitimit

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

10. TAKSE TREGU 30 lekë/m²

TARIFAT VENDORE

1.TARIFA E PASTRIMIT

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Maliq dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Kategorite	<u>Lekë në vit</u> <i>MALIQ</i>	<u>Lekë në vit</u> <i>VRESHTAS LIBONIK POJAN PIRG</i>	<u>Lekë në vit</u> <i>MOGLICE GORE</i>
Familjare	1200	1200	600
Ambulant	2500	2000	1500
BV (0 – 5 mil)-njesi tregetare dhe sherbimi	7000	5000	3000
<i>-Tregeti Mish, Peshk, Bar Kafe, Fast Food</i>	10000	7000	5000
BV (5 – 8 mil)-njesi tregetare dhe prodhimi	15000	15000	15000
<i>-Materiale ndertimi, Inerte, Mermere</i>	20000	20000	20000
BM -TVSH - njesi tregetare dhe sherbim	40000	40000	40000
<i>-Njesi Prodhimi</i>	60000	50000	40000
<i>-Frigorifere, Ferma, Pulari, Lloto</i>	50000	50000	30000
<i>-Hidrocentrale, Gurore, Ndertim (/kantier)</i>	100000	100000	100000
<i>-Institucione, Profesionet e lira,</i>	20000	17000	15000
<i>-Farmaci, Fondazione, OJQ, OJF</i>	10000	8000	6000
Transport udhetaresh – Vetura, Furgone	4000	3000	3000

Transport udhetaresh - Autobuza	9000	7000	7000
Transport malli	5000	4000	4000

-Afati i pagesës për tarifën e ndriçimit nga bizneset është data 30 Qershor 2017

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

2.TARIFA E NDRICIMIT

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Maliq.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshte.

Kategorite	<u>Lekë në vit</u> <i>MALIQ</i>	<u>Lekë në vit</u> <i>VRESHTAS LIBONIK POJAN PIRG</i>	<u>Lekë në vit</u> <i>MOGLICE GORE</i>
Familjare	600	600	200
BV(0-5mil)-njesi tregtare dhe sherbimi	1500	1000	500
BV(5-8mil)-njesi tregtare dhe prodhimi	2000	1500	1000
BM-TVSH - Institucione	6000	5000	4000

-Afati i pagesës për tarifën e ndriçimit nga bizneset është data 30 Qershor 2017

-Përfshihen nga pagesa e tarifës së ndriçimit përkohësisht fshatrat ku nuk kryhet ky shërbim.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës mbi ndriçimin është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

-Përfshihen nga pagesa e tarifës së ndriçimit përkohësisht fshatrat ku nuk kryhet ky shërbim.

3.TARIFA E GJELBRIMIT

Përkufizimi: Tarifa e gjelbrimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Maliq.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit, janë të shprehura si më poshtë:

Kategorite	Lekë në vit MALIQ	Lekë në vit VRESHTAS LIBONIK POJAN PIRG	Lekë në vit MOGLICE GORE
Familjare	100	0	0
BV(0-5mil)-njesi tregetare dhe sherbimi	900	700	500
BV(5-8mil)-njesi tregetare dhe prodhimi	1200	1000	800
BM-TVSH - Institucione	4000	4000	4000

-Afati i pagesës për tarifën e gjelbërimit nga bizneset është data 30 Qershor 2017

-Përfshihen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit përkohësisht fshatrat ku nuk kryhet ky shërbim.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifave: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbërimit është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Malë, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

4.TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE DHE MALLRAVE, DHËNIA E LEJËVE PËR USHTRIM AKTIVITETI

Tarifat e liqensimit të transportit të udhëtarëve	Njesia	Tarifa
Liqensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/linje/5 vjet	40000
-Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/mjet/vit	1000
Liqensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/linje/5 vjet	20000
-Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/mjet/vit	1500
Liqensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	lekë/linje/5 vjet	75000
Liqensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/linje/5 vjet	75000
-Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/mjet/vit	1500
Liqensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	lekë/license/5 vjet	15000
Liqensë për agjensi ndërkombëtare udhëtarësh	lekë/license/5 vjet	40000
Liqensë për transport udhëtarësh me taksi	lekë/mjet/5 vjet	20.000
Certifikate per koke terheqese	lek/mjet/vit	1500
Certifikate per mjete teknologjike	lek/mjet/vit	1500
Tarifat e Liqensimit të Transportit të mallrave	Njesia	Tarifa
Liqensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	lekë/license/5 vjet	40000
-Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	lekë/kapacitet	100x*
-Çertifikatë për transport mallrash për vehte brenda vendit	lekë/kapacitet	100x*
Tarifa e Parkimit per mjetet qe licenson Bashkia	Njesia	Tarifa

Mjete transporti udhetaresh - Furgona	leke/vit	5000
Mjete transporti udhetaresh - Vetura	leke/vit	3000
Mjete transporti udhetaresh - Autobuze	leke/vit	7000
Mjete transporti mallrash – Deri ne 2 ton	leke/vit	3000
Mjete transporti mallrash – Mbi 2 ton	leke/vit	5000
Mjete transporti udhetaresh nga Bashkite e Tjera	lek/ore qendrimi	50

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave : Drejtoria e Shërbimeve publike përcjell informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Drejtoria e të Ardhurave. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Drejtoria e të Ardhurave ne Bashkine Maliq.

5.TARIFA TE NDRYSHME

Niveli i tarifave te tjera: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

-Tarifa per zenien e hapësirave publike	Njesia	Tarifa
<i>Per qytetin e Maliqit</i>	leke/m2/muaj	60
<i>Per Njesite e tjera Administrative</i>	leke/m2/muaj	30
-Tarifa per dhenie leje NON STOP	Njesia	Tarifa
<i>Per Kazinote, Lojrat e fatit</i>	leke/vit	50000
<i>Per Bar Restorante</i>	leke/vit	10000
<i>Per pikat e Karburanteve</i>	leke/vit	25000
-Tarife per mjetet korese	Njesia	Tarifa
<i>Per mjete brenda Bashkise Maliq</i>	leke/vit	5000
<i>Per mjete jashte Bashkise Maliq</i>	leke/vit	10000
-Tarife per drute e zjarrit ne pyje komunale	Njesia	Tarifa
<i>Per familjare</i>	leke/vit/10mst	1000
<i>Per te tjere</i>	leke/vit/mst	300
-Tarifa per kullota (per 1 krere)	Njesia	Tarifa
<i>Per banoret vendas (te imta)</i>	leke/vit/krere	100
<i>Per te ardhurit nga zona te tjera (te imta)</i>	leke/vit/krere	200
<i>Per banoret vendas (gjedhe)</i>	leke/vit/krere	800
-Tarife gjuetie	Njesia	Tarifa
<i>Per Shoqaten e Gjuetareve (brenda Bashkise)</i>	leke/vit	2500
<i>Per gjuetare te tjere</i>	leke/vit	5000
-Tarife per ekspozim malli jashte dyqanit	Njesia	Tarifa
<i>Per qytetin e Maliqit</i>	leke/m2/dite	60
<i>Per Njesite e tjera Administrative</i>	leke/m2/dite	30
-Tarife per ujin e vaditjes (veterrjedhje)	lek/dynym	300
-Tarife per ujin e vaditjes (ngritje mekanike)	lek/dynym	200
-Tarife per kazane rakije	leke/vit	5000
-Tarife per tavolina jashte lokaleve (hapësire publike)	leke/dite/tavoline	30
-Tarife per mur te jashtem per cdo ndertese te re	leke/m2	20
-Tarife per depozitimin e mbetjeve ne Landfilde	leke/ton	200
-Tarife per mirembajtje te varrezave	lek/familje/vit	100

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës të tjera është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është njësia administrative.

-Tarifa për mirëmbajtje vorreze do të zbatohet vetëm në ato fshatra ku ky shërbim kryhet prej bashkisë;

☐ **PERJASHTOHEN:**

Në kategorinë “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga **tarifa vendore për biznesin**.

Përjashtohen nga **tarifa vendore**: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të Bashkisë Maliq; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Maliq; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

6 TARIFA PËR SHËRBIME NË BASHKI

Tarife për vërtetime të thjeshta	lek/cop	50
Tarife vërtetimi për pension	lek/cop	500
Tarife tërheqje bagëtie të imta	lek/krere	100
Tarife tërheqje bagëtie të trashë	lek/krere	150
Tarife për nxjerrje dokumenti nga arkivi	lek/cop	500
Tarife për bileta sportive	lek/cop	0
Tarife për bileta kulturore	lek/cop	100
Tarife për vërtetim tenderi ose ankandi	lek/cop	2000
Tarife për vërtetim për jashtë Shqipërie	lek/cop	500
Tarife dhënie me qera sallë e Pallatit të Kulturës	lek/aktiviteti	5000
Tarife dhënie me qera stadiumi	lek/ndeshje	10000
Autorizim për transport specifik (eskursionë, pritje, shoqata etj)	lek/cop	1000

7 TARIFA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Vërtetime të shoqeruara me fotokopje nga arkivi	lek/cop	500
Vërtetim i thjeshtë	lek/cop	50
Vërtetim pronesie me fotokopje	lek/cop	1000
Vërtetim pronesie për jashtë Shqipërie	lek/cop	1000
Aplikim për ndërtim të ri	lek/aplikim	1000
Kërkese për shtesë në ndërtimin ekzistues	lek/rast	1000
Kërkese për prishje objekti ekzistues	lek/rast	500
Leje për shpërrim të afatit të lejes së ndërtimit	lek/rast	500
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	lek/rast	500
Njoftim për fillimin e punimeve të ndërtimit	lek	500
Njoftim për raportin final të mbikqyrjes / kolaudit	lek	500
Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	lek	500
Plan vendosje për lidhje energjie	lek/cop	1000
Autorizim për riparim catie	lek/cop	3000

Autorizim per suvatim + lyerje fasade	lek/cop	2000
Autorizim per riparim muri rrethues	lek/cop	2000
Kerkese per Certefikate Perdorimi	lek/cop	2000
Tarife konfirmimi per cdo dokument pronesie	lek/cop	500
Vertetim per kufi pronash + skice	lek/cop	2000
Konfirmim konflikti pronash ne terren	lek/rasti	1000
Akt kontrolli I piketimit te objekteve – deri 3 kate mbi toke	lek	500
Akt kontrolli I piketimit te objekteve – mbi 3 kate mbi toke	lek	1000
Akt kontrolli pas perfundimit te themeleve – deri 3 kate mbi toke	lek	500
Akt kontrolli pas perfundimit te themeleve – mbi 3 kate mbi toke	lek	1000
Akt kontrolli pas perfundimit te godines	lek	500
Akt kontrolli te sistemeve te jashteme – deri 3 kate mbi toke	lek	500
Akt kontrolli te sistemeve te jashteme – mbi 3 kate mbi toke	lek	1000
Akt kontrolli pas perfundimit te punimeve – deri 3 kate mbi toke	lek	500
Akt kontrolli pas perfundimit te punimeve – deri 3 kate mbi toke	lek	1000
Punime mirembajtje ndertesash te jashteme	lek	2000
Punime mirembajtje ndertesah te brendeshme	lek	2000
Punime te tjera	lek	5000

8.TARIFA PER VERETITIME NGA DREJTORIA E BUJQESISE

Vertetim per formularin 6 per ne hipoteke	lek/copa	500
Vertetim per sigurimet shoqerore	lek/copa	100
Vertetim per ndihmen ekonomike	lek/copa	50
Tarife per zbatim te KKP	lek/copa	2000
Tarife konfirmimi per cdo dokument pronesie	lek/copa	500
Vertetim I thjeshte per dokument pronesie	lek/copa	50
Vertetim per kufi pronash + skice	lek/copa	2000
Konfirmim konflikt pronash	lek/copa	1000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave: Struktura e ngarkuar për vjeljen e ketyre tarifave jane Drejtorite perkatese të Bashkisë Maliq.

GJOBAT

1.GJOBA PER MOSSHLYERJE NE AFAT TE DETYRIMEVE

1.Gjoba për mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa) brenda afatit 30 Qershor	Për çdo muaj vonesë 5 % e vlerës së detyrimit total të papaguar (maksimumi 25%)
2.Nëse subjekti i ri ose adresa sekondare e re regjistrohen pas datës 30 Qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve është 30 ditë pas datës së regjistrimit.	Për çdo muaj vonesë 5 % e vlerës së detyrimit total të papaguar (maksimumi 25%)
3.Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore	Sipas Ligjit Nr.9920, dt. 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar

Gjobat aplikohen vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT). Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 30 Qershor e po këtij viti.

Baza e llogaritjes së gjobës përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës dhe taksa e truallit.

Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat dt. 30 Qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 30 Qershor, afati i fundit për shlyerjen e detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së regjistrimit.

Vlera e gjobës llogaritet 5% (pesë përqind) për muajin e plotë kalendarik brënda së cilës skadon afati, dhe 5% (pesë përqind) për çdo muaj të plotë kalendarik në vazhdim, por në asnjë rast shuma totale e gjobës nuk mund të jetë më e madhe se 25% (njëzet e pesë përqind) e detyrimit vjetor të papaguar.

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq. (sektori Tax Force)

2.GJOBA PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TREGËTAR PA LICENSE APO LEJE PËRKATËSE

a.Mospajisja me liqensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti :	ne leke
• transport udhëtarësh taksi (1+4)	10000
• transport udhëtarësh taksi (1+8)	15000
• mjete të tonazhit të lartë	20000
• hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit mjetet e tonazhit të lartë	15000
b. Mospajisje me liqensë për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse	30000
c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	2000
d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	5000
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	15000
f. Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike • veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	10000
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame : • e thjeshtë • elektronike	5000 15000

3.GJOBA PËR DËMTIM DHE NDERHYRJE NË INTRASTRUKTUREN RRUGORE

Emertimi	ne leke
a. Dëmtim rruge	5000
b. Çarje rruge	10000
c. Bllokim rruge	3000
d. Dëmtim bordure	10000
e. Dëmtim trotuari	10000
f. Çarje trotuari	10000
g. Bllokim trotuari	5000

h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	10000
------------------------------------	-------

4.GJOBA PER DËMTIMET DHE NDERHYRJET NE RRJETIN E NDRICIMIT RRUGOR

Emertimi	ne leke
a. Lidhje e pamiraturar në rrjetin ajror	10000
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	20000
c. Dëmtim i ndriçuesve	10000
d. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablllove etj.	5000
e. Dëmtim i traseve, kablllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave	20000
f. Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik	20000

5.GJOBA PER DËMTIMIN DHE NDERHYRJE NE RRJETIN E UJESJELLESIT

Emertimi	ne leke
a. Lidhje e pa miraturar në tubacion	5000
b. Dëmtim i pusetave dhe matesave te ujit	5000
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose paleje	10000

6.GJOBA PER NDERHYRJE DHE DËMTIME NE HAPESIRAT E GJELBERTA DHE ATO PUBLIKE

Emertimi	ne leke
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	5000
b. Dëmtim, prerje e pemëve	10000
c. Zënie e hapësirës të gjelbër pa leje	5000
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje	1000
e. Vendosje posterash pa leje	100 lek/cop
f. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane te subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate	10000

7.GJOBA TE INSPEKTORIATIT VETERINAR

a. Për mishin e therur të tregëtuar të pa çertifikuar nga Inspektoriati Veterinar	5000 lek
b. Per shkelje te sherbimit veterinar – bageti te imta	500 lek/krere
c. Per shkelje te sherbimit veterinar – bageti te trasha	5000 lek/krere

8.GJOBA PER DEDIME NE BUJQESI

a. Nderhyrje ne rrjetin vadites e kullues ne toka bujqesore	5000 lek
b. Zenie e tokes bujqesore, pyje e kullota	10000 lek
c. Ndotje e mjedisit nga pleherat, ujrat e zeza etj	5000 lek

Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Policia Bashkiake dhe Drejtoria e të Ardhurave ne Bashkine Maliq. (sektori Tax Force)

Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjen administrative".

Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj dhe që nuk janë përmendur në këtë material.

Përfshihen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.

Të gjitha subjektet që do aplikojnë pranë QKR për pezullim të aktivitetit nga data e aplikimit për pezullim deri në datën e aktivizimit nuk do të llogariten taksat dhe tarifatat lokale.

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë pranë Bashkisë Maliq, Njësitë Administrative si dhe Institucionet e Varësisë.

Te drejten per te dhene vertetime per shlyerje detyrimi per kategorine Biznes e ka vetem Drejtoria e te Ardhurave ne Bashkine Maliq e sigluar kjo nga Kryetari I Bashkise.

II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.

KRYETARI I KESHILLIT

ERISELD JONUSLLARI

